REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 118/17
Nr. i Sj. / Br. st
Data / Datum 08.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenin 5 pika 1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Dhënie të Dekoratave 01nr.88/15, dt. 30.04.2015 si dhe bazuar në Raportin e Jurisë Profesionale mbi përzgjedhjen e poezive "Festivali i Poeteshave Shqiptare 2016" dt. 28.11.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Znj. **Shefqete Gosalci**, fituese e çmimit të tretë të poezive në "Festivalin e Poeteshave Shqiptare 2016" i ndahen mjete financiare në shumë prej 200.00 € (dyqind euro).
2. Pagesa sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. 119/17
Nr. i Fq. / Br. st. 
Datat / Datum 08.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenin 5 pika 1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Dhënie të Dekoratave 01nr.88/15, dt. 30.04.2015 si dhe bazuar në Raportin e Jurisë Profesionale mbi përzgjedhjen e poezive "Festivali i Poeteshave Shqiptare 2016" dt. 28.11.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Znj. **Shahadije Lohaj**, fituese e çmimit të parë të poezive në "Festivalin e Poeteshave Shqiptare 2016" i ndahen mjete financiare në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro).

2. Pagesa sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 120/17
Nr. i Iig. / Za st.
Data / Datum 08.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, nenin 5 pika 1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Dhënie të Dekoratave 01nr.88/15, dt. 30.04.2015 si dhe bazuar në Raportin e Jurisë Profesionale mbi përzgjedhjen e poezive "Festivali i Poeteshave Shqiptare 2016" dt. 28.11.2016, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Znj. **Ermira Jusufi**, fituese e çmimit të dytë të poezive në "Festivalin e Poeteshave Shqiptare 2016" i ndahen mjete financiare në shumë prej 300.00 € (treqind euro).
2. Pagesa sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 153/17
Nr. i fq. / Br. st
Data / Datum 14.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4, nënpika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në vendimet e kuvendit të komunës 01Nr.75/12 dt.30.04.2012, Për rrënimin e objektit të Komunës, rregullimin e hapësirave dhe vendosjen e shtatores së "Hasan Prishtinës" dhe vendimi për aprovimin e buxhetit për vitin 2017 dhe listën e projekteve kapitale për v. 2017, 01.nr176/16 të miratuar në mbledhje të KK-së me datën 29.09.2016. Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 14.02.2017 merr këtë:

# VENDIM
## PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË PALUEJTSHME

### Neni 1

Fillohet procedura e shpronësimit të pronës të paluejtshme të pronarit privat/ zotëruesit të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për ndërtimin e sheshit në qytetin e Vushtrrisë, Komuna Vushtrri, për pjesën e ndërtesës-lokalit i cili gjendet në ndërtesën e administratës komunale si në vijim:

- O-70202016-06006-0-70-1-3-0, pjesë e ndertesës-lokal në sipërfaqe prej 60m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 60 m², ZK-Vushtrri, me pronar (qirambajtje per 99 vite) në pjesë ideale 1/1 Ndermarrja e Re Zyra e Jugobankës Vushtrri Sh.P.K me seli në Vushtrri, përfaqësuar nga Izet Maliqi nga Vushtrria, rr. "G.J.K. Skenderbeu", Komuna Vushtrri.

### Neni 2

Shpronësimi i pjesës së ndërtesës-lokalit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

### Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së Paluajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 175/17
Nr. i fq. / Br. st. 
Data / Datum 21.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të ftesës së Karolina Bisek BISEK - FINANSE Kancelaria księgowo – podatkowa dt. 10.02.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Komunës së Vushtrrisë për vizitë zyrtare në Krakovë – Poloni nga data 27.02 – 02.03.2017 për këta zyrtarë:

   1.1 **Bajram Mulaku,** Kryetar i Komunës,
   1.2 **Arta Haxhaj,** Drejtoreshë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
   1.3 **Sami Istrefi,** Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
   1.4 **Bedri Dobra** Drejtor për Gjeodezi dhe Kadastër

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi ju dërgohet: të lartpërmendurve dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br 179/17
Nr.i Dp./Br.st
Datum 22.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesë të dt. 22.02.2017 të znj. Afërdita Berisha nga USAID-i, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR CAKTIM TË ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR PRANIM FINAL (PËRFUNDIMTAR) TË PROJEKTIT

1. Z. **Ahmet Shuku**, zyrtar i komunës, caktohet anëtar nga komuna e Vushtrrisë në komisionin e përbashkët me USAID-in AKT-LS për pranim FINAL (përfundimtar) të projektit "Ndërtimi i trotuarit dhe instalimi i ndriçimit publik nga stacioni hekurudhor në fshatin Prelluzhë deri te ura mbi lumin "Llap" në fsh. Stanoc i Poshtëm" Komuna e Vushtrrisë.

2. Pranimi final të bëhet konform legjislacionit të zbatueshëm me të cilin është rregulluar kjo çështje.

3. Pranimi teknik bëhet me datën 23.02.2017, në ora 10;30.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: Përfaqësuesit të USAID-it, të lartpërmendurit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 183/17
Nr. i Sp. / Br. st.
Datar / Datum 23.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Komunës së Vushtrrisë në fushën e arsimit për vizitë zyrtare në Vaxjo - Suedi nga data 27.03 – 01.04.2017 për këta zyrtarë:

   1.1 **Avdullah Sadriu,** zyrtar i arsimit,
   1.2 **Habibe Gërxhaliu,** zyrtare e arsimit
   1.3 **Alban Maloku,** zyrtar i arsimit
   1.4 **Hadije Zuqaku,** zyrtare e arsimit
   1.5 **Zehra Kovaqi,** zyrtare e arsimit
   1.6 **Ali Pllana,** zyrtar i arsimit

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi ju dërgohet: të lartpërmendurve dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 192/17
Nr. i fq. / Br. st
Data / Datum 27. 02. 2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Automjeti zyrtar me targë të v. 2008 nr. 531 KS061, ndërsa tani me targë 02Z-10-27, "Toyota" , xhip, 5 dyer, dizel, ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 1999, i cili i është dhënë në shfrytëzim Njësisë së Zjarrfikësve në Vushtrri, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve 03nr.63, dt.05.02.2008, të kthehet në emër dhe menaxhim të komunës.

2. Me rastin e dorëzimit të duhet të bëhet barazimi i faturave për shpenzimet e krijuara të karburanteve deri në ditën e dorëzimit të automjetit.

3. Gjithashtu, me rastin e dorëzimit të këtij automjetit, libreza dhe çelësat e automjetit duhet të i dorëzohen Shefit të autoparkut të komunës.

4. Pranim dorëzimin ta bëjnë: Udhëheqësi i Njësisë së Zjarrfikësve dhe Shefi i Autoparkut të Komunës.

5. Vendimi i dërgohet: Udhëheqësit të Njësisë së Zjarrfikësve, Shefit të Autoparkut të Komunës dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 193/17
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum 27.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Nga plani buzhetor i zyrës së kryetarit të komunës për v. 2017, fondi 21, kategoria furnizim për zyrë, nga shuma e përgjithshme prej 9.640,00 €, të barten 2.300,00 € në kategorinë "Shpenzime për informim publik", për qëllimet e plotësimit të shumës së nevojshme për zotim për shërbimet e transmketimit përmes valëve të radios, për v. 2017.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet drejtoria për buxhet dhe financa.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku